

## PROCESVERBAL

(ekstrakt)

Nga seanca e 6-të (e rregullt) e Komitetit për Komunitete - Dragash, e mbajtur më 26.06.2023 në ora 11:00, me sa vijon:

### ***Rendi i ditës***

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar*
- 2. Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për seancën e 7-të të Kuvendit të Komunës,*
- 3. Eventuale*

Miralem Rahte - Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë të pranishmit, po hap takimin e 6-të të Komitetit për Komunitete për këtë vit, para fillimit të këtij takimi dua të konstatoj nëse kemi kuorum. Meqenëse kemi Më lejoni të bëj një pyetje, a e kanë marrë materialin të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete në kohën e përcaktuar ligjërisht, të përkthyer në gjuhët tuaja amtare? A ka dikush ndonjë fjalë për rendin e ditës? Po hedh në votim miratimin e axhendës së sotme të propozuar. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Meqenëse rendi i ditës është miratuar, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Dëshiroj t'i uroj mirëseardhjen kolegëve të mi nga Komiteti për Komunitete nga komuna e Malishevës. Mirë se vini. Ne si komitet vizituam komitetin e komunës së Malishevës, për të shkëmbyer përvojat tona, kjo ndodhi falë mbështetjes së OSBE-së, vizituam komunën e Malishevës, pamë punën e tyre. Kjo vizitë u realizua me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të punës së Komitetit. Pas këtij takimi, së bashku me mysafirët nga Malisheva, kemi një vizitë në Drejtorinë e Kulturës dhe Arsimit, si dhe një vizitë në muzeun tonë në komunën e Dragashit. Pas kësaj kemi një drekë të organizuar nga OSBE.

### **Pika I - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhje e mëparshme**

Miralem Rahte – A ka dikush për të thënë për këtë pikë të rendit të ditës dhe procesverbalit. Meqenëse nuk ka, e vura në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

Suada Bajrami - Përshëndetje për të gjithë! Ju uroj mirëseardhje bashkëpunëtorëve tonë nga Malisheva! Na si Kuvend i Dragashit nuk kemi informacion që kemi pas vizitë dikush atje, ose s'e di kush... kush ka qenë vizitor atje edhe me kënaqësi edhe na kishim marrë pjesë atje, me e pa punën e Kuvendit të Malishevës, edhe uroj bashkëpunim të mirë. Faleminderit! Veç një sqarim deshta me e ditë, kush ka qenë atje edhe çka kanë bo atje, se na jemi totalisht të painformuar.

Miralem Rahte – OSBE-ja më ftoi si kryesues të Komitetit si dhe shef të zyrës për komunitete. Ne ishim vetëm dy për t'u njohur me punën e Komitetit në Malishevë. Mendoj se ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe së shpejti anëtarët e Komitetit do të aktivizohen në këtë proces

të njohjes, punës dhe shkëmbimit të përvojave. Fillimisht, erdhëm në këtë takim për t'u njohur, vizituam Shtëpinë Shëndetësore në Malishevë, për të mësuar për përqindjen e punësimit nga komuniteti shumicë. Ne e vizituam shkollën fillore Malishevë. Ne vizituam pakicën. Le të shohim se si janë minoritetet në atë komunë, edhe pse nuk ka shumë anëtarë nga komuniteti pakicë, por kjo përvojë na ka ardhur në ndihmë të gjithëve.

Nedžmidin Sejdilar - Kryesues, mendoj se ju duhet urgjentisht një kurs shprehjeje. Ju thatë pak më parë se në atë vizitë morën pjesë anëtarë të Komitetit. Kur shpreheni, duhet t'i kushtoni vëmendje mënyrës se si shpreheni. Nuk e dija që edhe OSBE-ja diskriminon anëtarët e Komitetit. Nga të gjithë ne këtu, si mund të zgjidhnin vetëm juve edhe shefin e zyrës për komunitete. Dhe ju lutem, si e treta, mos e përdorni termin pakicë, ata janë pjesëtarë të komuniteteve joshumicë. Kur thua pakicë mund të jetë fyese.

Miralem Rahte – Faleminderit, sa i përket shprehjeve, edhe ju u inatosët kur ju thirra zotëri, ndaj nuk u kushtoj rëndësi kritikave tuaja në këtë rast. A don dikush tjetër për të folur? Këtë pikë po e vë në votim. Kush është pro, kundër, abstenim.

## **Pika II - Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për seancën e 6-të**

Miralem Rahte – Rendi i ditës i Kuvendit ka këto pika:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Miratimi i Kornizës Buxhetore Afatmesme (KAB 2024-2026)**
- 3. Eventuale**

Miralem Rahte - Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e Kornizës të mesëm buxhetor për 2024-2026. Lidhur me këtë pikë, mund të them se në një nga takimet me shefin e zyrës për komunitete, dhe me nënkryetarin e Komunës, pamë se norma që ka qenë në praktikë që nga viti i kaluar, përqindja e buxhetit është shpërndarë në menyrë korekte. Buxheti për fshatrat për sa i përket investimeve kapitale dhe sa ka marrë çdo fshat nga fondet është diçka tjetër, por mund të konkludojmë se përqindja e parave për fshatrat nga komuniteti joshumicë dhe norma që është vendosur në praktikë që nga viti i kaluar është përmbushur. A don dikush fjalën për këtë pikë.

Nedžmidin Sejdilar - Zoti Kolloni. Shpresoj se nuk do të zemëroheni pasi do t'ju drejtohem drejtpërdrejt, e dini që kam qenë i pranishëm edhe në Komitetin e kaluar kur është diskutuar për ujësjellësin qendror. Kolegët e mi ju bënë disa pyetje të cilave ju me shumë mjeshtëri iu shmangët përgjigjes konkrete. Në lidhje me këtë ujësjellës, më intereson konkretisht se çfarë do të ndodhë, sepse ju vetë thatë që do të ketë ujësjellës që do të çojë te rezervuari në disa fshatra dhe se nuk do të ndërtohet infrastruktura e fshatit. Më intereson konkretisht se çfarë do të ndodhë me ato fshatra ku nuk do të preket infrastruktura. A do të duhet të paguajnë vendasit pasi kanë zgjidhur ata veta për ujin dhe tjetër gjë mesa di ju keni filluar punën, nga vendi i quajtur Vllaska deri në Cisti kanë filluar gërmimet, madje edhe ekskavatorë kalonin nëpër prona private dhe qytetarët janë të

mërzitur. Para se të filloni këto punime, a keni pasur takime publike me banorët e këtyre fshatrave, a keni informuar Këshilla të fshatrave dhe a më keni dhënë përgjigje konkrete për këto pyetje.

Miralem Rahte - A don dikush tjetër për të folur? Këtë pikë po e vë në votim. Kush është pro, kundër, abstenoj.

### **Pika III – Eventuale**

Miralem Rahte – Në këtë pikë dua t'ua jap fjalën kolegëve tanë nga Malisheva nëse duan t'i drejtohen Komitetit tonë.

Amrush Helshani - Faleminderit, i nderuar kryesues i Komitetit! Përshëndetje, i nderuar nënkryetar i Komunës, të gjithë ju të pranishëm, anëtarë të këtij Komiteti! Unë jam Amrush Helshani, jam kryesues i Komitetit për Komunitete në Komunën e Malishevës, njëherit edhe anëtar i Kuvendit Komunal. Për mu është kënaqësi sot që gjendem në Komunën e Dragashit. Falënderoj përfaqësuesit e OSBE-së që e kanë kriju një mundësi të tillë, për me shkëmby përvoja në mes të dy komunave. Kjo vizitë ka një qëllim të mirë, sepse ne ma herët i kemi pasur anëtarët e këtij Komiteti nga Komuna e Dragashit në Komunën e Malishevës dhe sigurisht kemi ndarë përvojat tona, qofshin të mira apo... sigurisht që këta i kanë vlerësu, po edhe unë po shoh një organizim të mirë të këtij Komiteti dhe i uroj punë të mbarë. Unë, në shenjë respekti për punimet e këtij Komiteti, dëshiroj, nëse më lejohet me ftu nënkryetarin, kam dëshirë me e nda një simbol të Komunës së Malishevës për këtë Komitet, dhe ju presim, ju mirëpresim edhe herave tjera në Komunën e Malishevës, sepse vërtet, ne në Komunën e Malishevës kemi vetëm 56 anëtarë, janë 12 familje të komunitetit pakicë, të cilat jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Malishevës, por në Komunën e Dragashit po shoh që ka pak më shumë komunitete dhe sigurisht që na mundemi me marrë përvoja të mira edhe me i realizu ato në terren. Nënkryetar, nëse keni mundësi... është logo e Komunës së Malishevës, është një përshëndetje në emër të kryetarit të komunës, Ekrem Kastrati. Faleminderit për fjalën! Besoj që bashkëpunimin do ta vazhdojmë. Për çdo gjë që ju keni nevojë, më marrë ndonjë përvojë nga ne, jeni të mirëseardhur edhe jemi të hapur për bashkëpunim. Nënkryetar, faleminderit shumë për mundësinë!

Resul Fetahu - Faleminderit! Së pari ju uroj mirëseardhje në Komunën e Dragashit përfaqësuesve nga Komuna e Malishevës! OSBE, drejtorë komunalë, kryesues të Komitetit! Ju përgëzoj që keni bashkëpunim të mirë me Komitetin për Komunitete nga Komuna e Dragashit, shpresoj që edhe në të ardhmen të vazhdoni bashkëpunimin edhe më të mirë. Në emër të kryetarit Bexhet Xheladini, i cili nuk ndodhet këtu, ndodhet në Haxh, e falënderojmë edhe kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Ekrem Kastratin, edhe të gjithë banorët e Komunës së Malishevës! Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar - I nderum koleg nga Malisheva, ju falemnderit edhe një herë, po ju lutem mos e merrni praktikën nga ky Komitet, se ky Komitet është jofunksional. Na po mblidhna këtu veç thjesht për ta marrë një mëditje. Se edhe parëz e keni pa qysh e udhëheq qeky zotnia Komitetin, s'e la drejtorin me ma dhënë përgjigjen. Për atë arsye, ju falemnderit shumë që na keni vizitu, shpresojmë që edhe na do të ju vizitojmë juve, po praktikën e këtij Komiteti mos e merrni, se keni me dështu!

Miralem Rahte - Kemi një kërkesë të dërguar nga qytetarët e Dragashit në këtë Komitet. Unë do ta lexoj këtë kërkesë. Ne qytetarët e renditur më poshtë si taksapagues të kësaj komune shprehim mospajtimin dhe kundërshtimin tonë lidhur me projektin e ndërtimit të parkut që ndodhet në varrezat e qytetit. Duam të sqarojmë se nuk jemi kundër investimeve në parqe dhe zona të gjelbra. Në këtë rast konkret shprehim kundërshtimet tona për vendndodhjen, duke pasur parasysh se ky park ishte planifikuar të ndërtohej mbi varrezat e qytetit dhe se aty ku duhet të jetë parku ka një varrezë të vjetër të qytetit. Për sa i përket realizimit të këtij projekti, besojmë se do të jetë një investim i panevojshëm dhe i shpërdoruar. Ky projekt nuk i përshtatet kulturës dhe traditës sonë të ndërtimit të parqeve mbi varreza. Me këtë peticion, kërkoj nga autoritetet e lartpërmendura që të rishqyrtojnë këtë projekt. Më poshtë janë nënshkruesit e këtij peticioni... Për këtë kërkesë jam konsultuar edhe me kryetarin e komunës, ndërkohë kemi edhe një kundërpeticion, i cili ka më shumë nënshkrues, një peticion që vjen nga Këshilli i fshatit Dragash dhe vula e tyre. Se ky park duhet të ndërtohet në atë vend. Në këtë ka më shumë firma, sugjerimi im është që të presim që drejtorja e urbanizmit të marrim një vendim dhe ekspertët të përcaktojnë këto fakte.

Nedžmidin Sejdilar - E di që qeveria u përgjigjet peticioneve me kundërpeticion, këtë patëm rastin të shohim në kaosin që ndodhi në seancën e kaluar. Edhe atëherë kam kritikuar qeverinë, e cila është ajo që mund t'i ekspozojë dhe kritikojë publikisht nënshkruesit dhe kështu nënshkruesit e parë u përballën me kërcënime dhe shantazhe të tjera të ndryshme. Më vjen mirë që qeveria për të shlyer borxhet nga fushata elektorale tani kërkon të ndërtojë një parking për njeriun e tyre dhe një park pranë restorantit të tij. Më vjen shumë mirë që autoritetet organizuan një kundërpeticion për të. Dhe kjo funksionon shumë mirë për mua, jam i lumtur për këtë. Sepse pas kësaj personalisht do të bëj procedim penal ndaj personave të caktuar të kësaj komune. Unë personalisht do të bëj procedim penal, si për kanosje, ashtu edhe për shantazh dhe për shpërdorim të buxhetit publik.

Miralem Rahte - A deshiron dikush tjetër me marr fjalën? Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë, e mbyll seancën e sotme të Komitetit për Komunitete. Faleminderit.

***Kryesuesi i Komitetit: Miralem Rahte***

---